



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:293993

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766279

C.nr.400/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, përmes gjyqtarës Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gerdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. D. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS.” nga Prishtina, Rr. “Bl. D. K.”, Ul. C-..., 2/.. hyrja 1..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Islam Rexheplar nga Dragashi, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, lidhur me kompensimin e avansimit ne karrier dhe zhvillim profesional, me vlerë të kontestit 3,708.45 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. D. nga fshati..., Komuna e Dragashit ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit në emër të kompensimit te avansimit ne karrier dhe zhvillim profesional - pagesës shtesë të të ardhurave për shtesën per kualifikim në lartësi 27 % të pagës bazë dhe ate: për periudhën kohore prej dates 01.01.2019 e deri me datën 22.11.2022, përkatësisht për 47 muaj nga 55.35 euro për secilin muaj, **t’ia paguaj shumën e pergjithshme prej 2,601.45 Euro (dymijë e gjashtëqind e një euro e katërdhjetë e pesë centi)**, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data 23.12.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e gjykuar si në piken I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi mbi shumën prej 2,601.45 euro e deri në shumën prej 3,708.45 euro dhe atë në shumën prej 1.107.00 € (njëmijë e njëqind e shtatë euro).

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 145.00 € (njëqind e katërdhjetë e pesë euro), në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përbarimit të dhunshëm. **REFUZOHET SI E PA BAZUAR** pjesa tjetër sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore mbi shumën prej 145.00 e deri ne shumën prej 249.00 euro dhe atë shumën prej 104,00 euro (për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë).

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, më datë 23.12.2021, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Dragashit, me objekt kontesti kompensimit e avansimit ne karrierë dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë edhe atë për periudhën 18.04.2017 – 22.01.2021 e deri në marrjen e aktgjykimit. Përfaqësuesja e paditësit përmes parashtresës së datës 29.03.2024, e ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë-kërkesëpadi ku perveq kompensimit e avansimit ne karrierë dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë edhe atë për periudhën 18.04.2017 -21.10.2021 ka zgjeruar duke kerkuar dhe kompensimin per periudhen nga data 22.11.2021 deri me date 21.11.2022 e me vlerë të përgjithshme monetare prej 3,708.45 €, duke theksuar se: Në padinë e dorezuar prane kesaj gjykate është theksuar se kërkesëpadija është e mbështetur në Kontraten Kolektive të Arsimit neni 7 paragrafi 1, pika 1.3, e nënshkruar me dt.18.04.2017 Udhëzimin Administrativ nr. 24/2014, nenin 21 si dhe nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dispozitat e të cilave kanë paraparë zbatimin dhe obligimin e te paditurës lidhur me kërkesëpadinë e parashtruar nga paditësi në këtë gjykatë. Përpos Kontratës Kolektive Sektoriale per Arsim, Kërkesëpadija ka mbështetje ligjore dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/33 të datës 29.08.2008, ashtu qe në pikën 3 të këtij vendimi percaktohet: ngritja e pages për mesimdhënës, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesional ne nivelin fillor dhe atë të mesëm behet ne bazë të kriterëve të licencimit, si pergatitja profesionale (kualifikimi) dhe pervoja e punës. Ndersa ne pikën 4.3 të Vendimit të cekur me lartë percaktohet se: "Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje te pageses bazë prej 27% ". Ndërsa ne pikën 4.4 percaktohet se: "Me diplomë të ciklit te dytë dhe tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje te pageses bazë prej 35% si dhe në Mendimin juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ka theksuar se paditësi është i punësuar te e paditura, në cilësinë e mësimehdhënësit, i njëjti është i licencuar dhe se ka bërë kërkesë tek e paditura për kompensim, por që kërkesa e paditësit është refuzuar, ka shtuar se e paditura, paditësit i ka paguar shumën prej 58.32 euro në muaj në emër të kompensimit e avansimit në karrier dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë, ashtu që diferenca e mbetur për një muaj është shuma 55.35 euro. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë paditësit shumën e lartëcekura edhe atë nga muaji prill 2017 deri në muajin nentor 2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe ate sipas tarifës OAK-së, per përpilimin e padise ne shunte prej 104.00 Euro, taksën per padi 41.00 Euro dhe për përpilimin e kesaj parashtrëse ne shumën prej 104.00 Euro, gjithësej në shumën e përgjithshme prej 249,00 Euro.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësve.

Gjithashtu të paditurës i është dërguar dhe parashtresa e paditsit e datës 29.03.2024.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 30.11.2023, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se nuk gjen mbështetje ligjore, nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, nga arsyeja se kontratës kolektive i ka kaluar afati duke u bazuar ne ligjin e punës në bazë të së cilit afati i kontratës kolektive në zbatim është tri vjet, ashtu që gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke u thirrur dhe në parashkrim, Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhenjen e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jepë aktgjykimin me të cilën e pranon si të themelt kërkesëpadinë”*.

E paditura deri me marrjen e aktgjykimit nuk ka paraqit përgjigje në parashtrësën e paditëses të datës 29.03.2024.

Gjykata, për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore i ka administruar këto prova materiale, edhe atë: Lista e pagave në emër të paditësit, Kontrata e punës në emër të paditësit, Diploma “Bachelor” në emër të paditësit, Licenca e mësimdhënësesit në emër të paditësit si dhe Vërtetimin e stazhit të punës nga SHFMU “S. E.” në fshatin K. e datës 23.06.2021, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe u aprovua për atë pjesë kurse është refuzuar për pjesën tjetër.

Nga Listat e pagave në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Nga Kontratat e punës në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura me Kontratë 1 (në kohë të pacaktuar) në pozitën e mësimdhënësit klasor.

Nga Diploma Nr.52 “Bachelor” e dt. 07.02.2013 në emër të paditësit Sh. (T.) D., gjykata vërtetoi faktin se paditësi me datë 25.05.2012, i ka përfunduar studimet Bachelor në programin e avancimit të kualifikimit të mësimdhënësve pranë Universitetit të Prizrenit, në Fakultetin e Edukimit - Qendra në Prizren, Programi Fillor dhe ka marrë titullin “Bachelor i Programit Fillor”.

Nga Licenca e mësimdhënësit Nr.10001...., gjykata vërtetoi faktin se paditësi, është pajisur me licencë të karrierës nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë edhe atë për periudhën nga data 01.03.2013 e deri më 01.03.2018.

Nga administrimi i Vërtetimit mbi stazhin e punës lëshuar nga SHFMU “S. E.” në K. e datës 23.06.2021, gjykata vërteton se paditësi Sh. D. është punëtorë i kësaj shkolle nga data 01.09.2002 dhe ende vazhdon të punon në këtë shkollë si arsimtar.

Gjykata ka administruar edhe prova tjera materiale, mirëpo të njejtat ishin pa ndikim për të vendosur ndryshe.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësi është punësuar pranë të paditurës, as pagat bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim të kualifikimit - licencimit shkollor për paditësit.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themelt kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar

se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si dhe duke mar për bazë dhe ekonomizimin e procedurës.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje: KKAK-së), të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe është mbështetur edhe në Mendimin juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Sipas nenit 2 parag.1 dhe 2 të Ligjit të punës, është paraparë se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”,* kurse sipas 90 të këtij ligji, është paraparë se: *“1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. Organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. Organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. Nivel të vendit,2.2. Nivel të degës,2.3. Nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”,* ndërsa me nenin 4, parag. 2 të po këtij ligji, është paraparë se: *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”,* e po ashtu lidhur me këtë sipas nenit 3 parag.1 pika 1.8 i këtij ligji ka paraparë se *shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:”Kontrata kolektive është marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”* kurse me pikën. 1.11 të po këtij paragrafi është paraparë se: *“Kontrata e punës është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. Sipas nenit 8 parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”. Kurse sipas nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është paraparë se: “Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në*

fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit". Ndërsa në bazë të nenit 33 par.1 pika 1.1. të UA Nr.05/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë thuhet se: "*Vazhdohen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014...*".

Ndërsa në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, është përcaktuar shprehimisht në pikën 4 se, *Mësimdhënësve me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27 % të pagës bazë*, çka paditësi në rastin konkret është kualifikuar me përgatitje shkollore me fakultet bachelior, ndërsa sa i përket lartësisë së kompensimit gjykata pati parasysh pagën bazë të paditësve në lartësi prej 421.00 euro.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh provat materiale në shkresat e lëndës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, ka të kryer studimet bachelor dhe është licencuar si mësimdhënës i karrierës nga MASHT-it, pagën bazë e kanë në lartësi prej 421.00 euro.

Gjykata gjeti se paditësit i takon kompensimi me rastin e avansimit në karrierë dhe zhvillim profesional në lartësi 27 % të pagës bazë, kompensimi në diferencë, ashtu që gjykata të njëjtit i ka aprovuar shumën e kërkuar që përcillet me ngritje page 27% të pagës bazë për periudhën të përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për shumën e gjykuara dhe aprovuara, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse për shkak të ekonomizimit të procedurës ngase shumën ishin lehtë të kalkulueshme dhe të qarta për gjykatën (plotesimi i padisë nga veti paditësi lidhur me kalkulimin e shumave).

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me fakultet, pasi që është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro për çdo muaj. Po ashtu nga lista e pagave shihet se paditësit Sh. D. në emër të kualifikimit me fakultet, i takon lartësia prej 27% të pagës bazë, ndërsa i është paguar shumën prej 58.32 €, e që në fakt është dashur të paguhet 113.67 €, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësi për këtë pjesë edhe atë për 47 muaj nga 55.35 €, apo në shumën të përgjithshme prej 2,601.45 €, andaj kjo përlllogaritje për gjykatën ka qenë e sakte dhe reale dhe nuk ka kërkuar ekspertizë shtesë.

Gjykata gjithashtu shqyrtoj edhe aspektin e afatit të licencës së paditësit – mësimdhënësit, e cila licencë ka qenë me afat prej pesë (5) vitësh edhe atë deri më 01.03.2018 dhe të njëjtën e vlerësoj se është në harmoni me UA Nr.05/2017 për Sistemin e e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë e ku thuhet se: "*Vazhdohen për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014...*" (neni 33 par.1 pika 1.1 të UA-së nr.05/2017), faktë ky që dëshmon se këto licenca janë valide deri më 01.03.2025.

Në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Dragashit.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, nga arsyeja se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk ka buxhet për zbatimin e kësaj kontrate, duke përfshirë edhe kundërshtimet tjera të cekura në përgjigjen në padi, gjykata vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njëjta prodhon efekt juridik edhe ndaj Komunës së Dragashit, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 parag.1 pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: *“Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar.....”*, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cekur se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj)...”*. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njëjtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KKAK.

Nga se u tha më lartë, duke pasë parasysh faktin se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së saj lidhur me kërkesën e parashtruar, i njëjti si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkoj përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj duke pasë parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e e paditura nuk i ka përmbushur detyrimet e saj ndaj paditësve, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditësvë t’ia kompensoj shumat e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën tjetër në shumën prej 1.107,00 euro (periudha kohore prej datës 18.04.2017 deri me date 23.12.2018), me arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënjes së punës është rregulluar me dispozitat të Ligjit të Punës në nenin 87, sipas të cilit citoj: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, edhe e paditura është thirrur në parashkrim. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 23.12.2021.

Gjykata për kamatën ligjore ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/, ku shprehimisht është përcaktuar se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësve dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga e autorizuara e paditësve, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: Për përpilimin e padisë, shumën prej 104.00 euro, dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 41.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 145.00 euro.

Ndërsa sa i përket shumës prej 104.00 euro, për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë, gjykata e refuzoi në tërësi nga fakti se përfaqësuesja e paditësit me fajin e saj, përmes padisë fillestare nuk e ka paraqitur padinë e rregullt dhe të plotë konform nenit 99 dhe 253 të LPK-së.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, parag.1 lidhur me nenin 262 parag.1 dhe 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:293993, 31.05.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate e në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.